



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 29.04.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.04.2022, të parashtruar nga **Grupi i Operatorëve Ekonomik TECH VISION SH.P.K.; Mehmet Sahitolli B.I.; Nita Macula B.I.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative “ , Nr. i prokurimit- 632-21-10162-5-5-8, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim **Grupit të Operatorëve Ekonomik TECH VISION SH.P.K.; Mehmet Sahitolli B.I.; Nita Macula B.I.**, e dt.26.04.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative “ , Nr. i prokurimit- 632-21-10162-5-5-8, Nr. i brendshëm-632-21-157-121, kundër **NJOFTIM PËR ANULIMIN EV DHËNIES SË KONTRATËS** , te AK –së, të datës 22.04.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIM PËR ANULIMIN E DHËNIES SË KONTRATËS, të publikuar me datë 22.04.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë aktivitetin e prokurimit me operatorin ekonomik të radhës;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.26.04.2022, **Grupi i Operatorëve Ekonomik TECH VISION SH.P.K.; Mehmet Sahitollu B.I.; Nita Macula B.I.**, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: “Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative “ , Nr. i prokurimit- 632-21-10162-5-5-8, Nr. i brendshëm-632-21-157-121.


Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 29.04.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Pretendimi juaj se Autoriteti kontraktues, ka bërë shkelje të LPP-së, duke bërë anulimin e Njoftimit për dhënie të kontratës nuk qëndron, sepse shkelja do të bëhej nëse nuk do të bëhej anulimi I dhënies dhe të lidhej kontrata.

Neni 31.3 i RRUOPP-

“Përiudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. përiudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës”

- Me dt.24.02.2022, Autoriteti kontraktues, përmes platformës elektronike, ka kërkuar nga OE pjesmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit zgjatjen e validitetit të ofertës, prandaj pretendimi juaj se nuk keni pranuar kërkesë për zgjatjen e validitetit nuk qëndron(shih figurën).



- Ju nuk keni bërë vazhdimin e validitetit të ofertës, e cila gjë njëherë nuk është vërejtur - i ka ikur Autoritetit kontraktues dhe në momentin kur është vërejtur, menjëherë është bërë anulimi i dhënies, sepse bazuar në **Neni 31.6 të RRUOPP**, një gjë e tillë ju bën “ të papërgjegjshëm” :

“Është e hapur për secilin OE të vendosë nëse dëshiron të përtërijë validitetin e tenderit apo jo. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si “të papërgjegjshëm” dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre”

- Për faktin se keni bërë porositjen e furnizimeve dhe pagesën e faturave, kjo nuk është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues, sepse nuk kemi pasur kontratë të lidhur e as nuk keni marrë urdhëresë për fillimin e furnizimit.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës